

ALBPETROL SH. A
RAPORTI I DREJTIMIT TË BRENDSHËM
PERIUDHA VJETORE 2022

TË DHËNA DHE INFORMACIONE PËR SHOQËRINË TREGTARE – ALBPETROL SH. A

| | |
|-----------------------------------|-----------------------------|
| Numri unik i identifikimit (NUIS) | J82916500U |
| Emri | ALBPETROL SHA |
| Data e themelimit | 30/04/1999 |
| Adresa e zyrës qendrore | Fier Patos PATOS L. 29 MARS |
| Vlera e Kapitalit | 14.735.229.000 Lekë |

Albpetrol Sh. A. është shoqëria shtetërore e naftës në Shqipëri e themeluar më 30 Prill të vitit 1999, e cila trashëgoi të gjitha asetet dhe vendburimet e naftës në Shqipëri.

Selia qendrore e kompanisë ndodhet në qytetin e Patosit ndërsa shoqëria ushtron aktivitetin e saj dhe në qendrat e prodhimit në Fier, Gorishtë, Kuçovë.

Albpetrol Sh. A është në pronësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është kërkimi dhe prodhimi i hidrokarbureve, i cili përfshin ciklin e plotë të punimeve sizmike, gjeologjike, mekanike, gjeofizike, kërkimin, nxjerrjen, marketimin e naftës bruto në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj. Kjo përfshin, gjithashtu, hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm në përputhje me interesat e saj. Gjithashtu, Albpetrol Sh. A është kompania shtetërore e ngarkuar me monitorimin e Marrëveshjeve Hidrokarbure të lidhura me kompanitë koncesionare.

Gjatë vitit 2022 aktiviteti kryesor i zhvilluar, në përputhje edhe me objektin e saj në statut, është: “Kryerja e Operacioneve Hidrokarbure në përputhje me ligjin nr. 7746, datë 28.08.1993, “Për Hidrokarburet (Kërkimi dhe Prodhimi)”, për kërkimin, zhvillimin, prodhimin, trajtimin, transportin, magazinimin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe çdo operacion tjetër tregtar apo shërbime që i shërbejnë aktivitetit të shoqërisë.

Shoqëria, brenda hapësirave të parashikuara nga legjilacioni në fuqi, do të kryejë çdo operacion projektues - preventivues, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin, gjithashtu, hapjen e veprimtarisë dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo aktivitet tjetër të mundshëm e të ligjshëm në përputhje me interesat e saj.

Realizimi i objektit të veprimtarisë të shoqërisë do të bëhet nëpërmjet shfrytëzimit dhe zhvillimit të zonave ekzistuese naftëmbajtëse dhe ato gazmbajtëse të vendit, kërkimeve të reja dhe zhvillimit të blloqeve në administrim, si dhe shfrytëzim të rërave bituminoze. Praktika, atributet e ish- APC-së Tiranë, që kanë të bëjnë me kërkim - prodhimin e hidrokarbureve i kalojnë shoqërisë Albpetrol Sh.A duke filluar nga data 01.04.2003.

- Furnizimi me energji elektrike të klientëve të kualifikuar;
- Tregtimi i energjisë elektrike;
- Shpërndarja e gazit natyror;
- Leje mjedisore për veprimtari me ndikim në mjedis për vendburimet e naftës në zonat Kuçovë,

Patos – Marinëz, Qendrën Mekanike Kuçovë, QSHGJ, Gorisht-Kocul, Amonicë, QASHNG, për vendburimet e gazit në zonën Divjakë - Lushnjë, Frakull-Fier, Povelçë-Fier, Finiq - Sarandë, rrjeti i transmetimit të produkteve të naftës dhe të gazit, vendburimi i rërës bituminoze Kasnicë-Fier, Uzina Mekanike Kuçovë dhe Uzina Mekanike Patos.

Objektivat tona

Në kryerjen e aktiviteteve është pasur parasysh gjendja e rezervave të nxjerrshme, gjendja e rezervuarëve, niveli tekniko - profesional i punonjësve, gjendja e puseve, kushtet dhe treguesit e shtresës, treguesit e prodhimit të puseve e të objekteve naftë e gazmbajtëse, infrastruktura sipërfaqësore, logjistika mbështetëse, tregu hidrokarbur, çmimet e naftës bruto në bursë etj.

Referencë e rëndësishme është dinamika e realizimit të kuotave të prodhimit vjetor të naftës si dhe Studimi teknik mbi strategjinë e zhvillimit të vendburimeve në vitet e ardhshme.

Misioni

Realizimi i veprimtarisë së Shoqërisë bëhet i mundur nëpërmjet zhvillimit dhe shfrytëzimit të vendburimeve ekzistuese të naftës dhe ato të gazit, të cilat janë në administrim të shoqërisë “Albpetrol” Sh. A, kërkimeve të reja dhe zhvillimit e prodhimit të hidrokarureve në blloqet që ka në administrim, si dhe shfrytëzimit të rërave bituminoze, furnizimit me energji elektrike të klientëve të kualifikuar, tregtimit të energjisë elektrike.

MODELI ADMINISTRATIV

Modeli i biznesit


Albpetrol Sh. A është një shoqëri aksionere që funksionon në baze të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar. Aksionet e shoqërisë zotërohen 100% nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Sistemi i administrimit të shoqërisë, bazohet në sistemin administrativ me 2 nivele.

Drejtimi i Albpetrol Sh. A përbëhet nga:

| Kryetari këshillit mbikqyrës | Anëtarët këshillit mbikqyrës | Administratori |
|------------------------------|---|-------------------|
| Ilia GJERMANI | Evis MAMAJ Ermal NUFI Stefanaq KOÇOLLARI Ardi VELIU Florenca KORBI | Eltar DEDA |

Struktura organizative e “Albpetrol” Sh. A më 31 Dhjetor 2022 paraqitet si më poshtë:



Struktura organizative e kompanisë është mjaft fleksibël, dhe krijon mundësi të vazhdueshme për përmirësime të mëtejshme. Politikat e burimeve njerëzore kanë në fokus përzgjedhjen dhe rekrutimin e stafit të kualifikuar, zhvillimin e njohurive, menaxhimin e performancës dhe vlerësimin në vlerat e stafit. Barazia gjinore dhe mosdiskriminimi, përbëjnë gjithashtu një vlerë të kompanisë.

Politikat dhe kujdesi i duhur

Përcaktimi i kuotave të nxjerrjes së naftës dhe gazit është analizuar në veçanti për çdo vendburim mbi

bazën e veçorive të vendburimeve.

Element përcaktues janë veçoritë gjeologjike të shtratimeve, rezervat e nxjerrshme të naftës, faza aktuale e shfrytëzimit të tyre, koeficientët natyrorë të rënieve.

Situata e përgjithshme e vendburimeve gëlqerore paraqet një stad të avancuar të shfrytëzimit të tyre dhe karakterizohet nga një shkallë e lartë inondimi nga ujrat shtresorë dhe faktor i ulët gazor deri dhe me regjime gravitacionale kryesisht në vendburimet ranore.

Në këto kushte të përgjithshme prioritet ka qenë dhe mbetet përshtatshmëria e metodave të shfrytëzimit sipas karakteristikave dhe llojit të vendburimeve.

Nisur nga sa më sipër nuk mendojmë projekte dhe shpime të reja pusesh që do të rrisnin numrin aktiv të tyre në shfrytëzim, ndaj mbështetje kryesore do të jetë mbajtja e numrit aktiv të pusëve aktualë me punimet e remontit nëntokësor si dhe riaktivizimi i pusëve të fondit të ndalur në të gjithë vendburimet, performime të pusëve të veçantë, por edhe në projekte pilot për implementimin e metodave të dyta (EOR), siç është ajo e injektimit të polimereve etj.

Në vendburimet gëlqerore orientim bazë do të jetë optimizimi i përqindjes së ujit në fluid nëpërmjet regjimeve të shfrytëzimit për çdo grupim pusesh e deri për çdo pus.

Rreziqet kryesore dhe menaxhimi i tyre

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin dhe analizën e risqeve që mund të kenë rëndësi për arritjen e objektivave të institucionit dhe përcaktimin e një përgjigjeje të përshtatshme ndaj këtyre risqeve.

Menaxhimi i riskut, është një proces i vazhdueshëm, duke trajtuar në mënyrë metodike të gjitha rreziqet që mund të ndikojnë aktivitetin në të tashmen dhe të ardhmen.

Dokumentimi i procesit të menaxhimit të riskut bëhet nëpërmjet regjistrimit të riskut ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Ndikimi dhe mundësia e ndodhjes së riskut duke e kategorizuar atë si të lartë, të mesëm apo të ulët;
- Rivlerësimi i riskut, i cili duhet matur çdo vit si pjesë e një procesi formal të veprimtarisë së njësisë;
- Përgjigja ndaj çdo risku duhet të identifikohet.

Identifikimi i risqeve bëhet në nivel njësie dhe nivel veprimtarie, gjithashtu dhe në kategori të jashtëm apo të brendshëm dhe për të gjitha risqet e identifikuara, do të caktohen zotëruesit përkatës të cilët kanë përgjegjësinë që risqet të menaxhohen dhe monitorohen gjatë gjithë kohës.

Albpetrol mbart procedura, të cilat përfshihen në strategjinë për menaxhimin e riskut - për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të venë në rrezik përmbushjen e objektivave të njësisë.

Kuadri Ligjor Rregullator kryesor, në bazë dhe në mbështetje të të cilit ushtron aktivitetin shoqëria Albpetrol Sh. A.

I. LIGJE:

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7746, datë 28.07.1993, “Për Hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi), i ndryshuar;

- Ligji nr. 7582, datë 13.07.1992, “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7926, datë 20.04.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare” i ndryshuar;
- Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999, “Për përpunimin transportimin dhe tregtimin e naftës dhe gazit natyror dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 102/2015 ”Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar;
- Ligji 43/2015, datë 30.04.2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”;
- Ligji nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, i ndryshuar;
- Ligji nr.10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 8/2017, “Për Statusin e Punonjësve të Industrisë së Naftës dhe Gazit”;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 10296, datë 08/07/2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”;
- Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”;

II. VKM:

- VKM nr. 491, datë 19.07.2017, “Për përcaktimin e rregullave, të kushteve teknike dhe normave të mirëmbajtjes së instalimeve nën presion, që shërbejnë për përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e naftës,të gazit dhe nënprodukteve të tyre;
- VKM Nr. 279, datë 12.4.2012, “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.07.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol”, sh.a.)”, i ndryshuar;
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 570, datë 3.10.2018 “Për Këshillat Mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”;
- VKM nr. 429, datë 26.6.2019 për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil e industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor);
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar me vendimin nr. 823, datë 21.10.2020;
- VKM nr. 874, datë 29.9.2021, “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.

III. URDHRA/ UDHËZIME/ RREGULLORE/ MARRËVESHJE:

- Urdhër nr. 258, datë 03.08.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin Nr. 83, datë 10.2.2012 “Për rregullat dhe procedurat e shitjes së produkteve hidrokarbureve (naftë bruto)”, të ndryshuar;
- Urdhër nr. 187, datë 18.12.2020, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar";
- Urdhër nr. 188, datë 18.12.2020, i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Për miratimin e Regjistrimit të kërkesave dhe përgjigjeve të rishikuar";
- Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”;
- Rregullorja “Për përcaktimin e procedurave të Miratimit të Marrëveshjes Hidrokarbure Licencë Marrëveshjes, si dhe afatet përkatëse”, miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me Urdhër nr. 246, datë 12.03.2018 “Për miratimin e Rregullores për përcaktimin e procedurave të miratimit të Marrëveshjes Hidrokarbure, Licencë Marrëveshjes si dhe afatet përkatëse”;
- Marrëveshje e datës 26.07.1993, midis Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetike dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit, me objekt “Autorizim për kryerjen e operacioneve hidrokarbure” e cila më vonë është bërë pjesë e Ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (Kërkimi dhe prodhimi)”, i ndryshuar.

IV. DOKUMENTE TË TJERA:

- Statuti i Shoqërisë Albpetrol Sh.A me nr. 1643/7 prot., datë 27.02.2012;
- Rregullore e Shoqërisë Albpetrol Sh. A, miratuar me Vendim nr. 20 datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikqyrës;
- Struktura Organizative e Shoqërisë Albpetrol Sh. A, miratuar me Vendim nr. 19 datë 03.12.2020 të Këshillit Mbikqyrës;
- Kontrata Kolektive e lidhur midis Shoqërisë Albpetrol Sh. A, Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë dhe Sindikatës së Sektorit Hidrokarbur (SSH) nr. 1026 prot., datë 10.06.2023.
- Kodi i Etikës i Shoqërisë Albpetrol sh.a.
- Vendim i ERE Nr. 140, datë 6.9.2017 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” Sha, në Aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike;
- Vendim i ERE Nr. 141, datë 6.9.2017 “Mbi licencimin e shoqërisë “Albpetrol” Sh.A, në Aktivitetin e furnizimit të Energjisë Elektrike.

ASPEKTET TEMATIKE

Çështjet mjedisore

Gjate vitit 2022 shoqëria Albpetrol.sh.a pjesë të punës së saj ka patur edhe monitorimin, ruajtjen dhe zbatimin e ligjshmerisë së mjedisit dhe sigurisë në punë, vecanerisht shëndetin e punonjësve. Gjate kësaj periudhe, problem për shoqërinë kanë ngjellur ndotjet të cilat janë të trashëguara si sabiet

naftore ne sheshet e puseve , kimikatet e skaduara ,baterite e dala jashte perdorimit, eternitet, gomat jashte perdorimit etj.

Jane ndermarre masat e duhura per sigurine ne pune, ne kushtet qe industria e naftes eshte komplekse ku rreziqet per shendetin jane permanente, pasi kemi te bejme me ngarkesa te renda, rreziqe elektrike,forca madhore natyrore, mjete te renda levizese,pune nentoksore etj. Po keshtu eshte lidhur kontrata e sigurimit te jetes per 1400 punonjesit qe punojne ne vendet me rrezikshmeri te larte.

Gjithashtu ka vazhduar te kryhet njohja dhe zbatimi i Rregullores te Sigurimit teknik ne industrine e naftes per te gjithë punonjesit nga specialistet perkates ne cdo qender te shoqerise dhe vecanerisht me e detajuar per punonjesit e emeruar rishtazi .

Çështjet sociale dhe të punonjësve dhe të drejtave të njeriut

Njësia është e përkushtuar për trajtimin e çështjeve sociale dhe të sigurisë në punë. Kjo për faktin se shoqëria ka një numër të lartë punonjësish si dhe për faktin se industria paraqet rreziqe komplekse për jetën dhe shëndetin në mënyrë permanente.

Për këtë i kushtohet rëndësi njohjes dhe zbatimit të rregulloreve te sigurimit teknik si dhe investimeve në rinovimin e teknologjisë dhe pajisjeve që përdoren.

Gjithashtu shoqëria ka lidhur kontrata për sigurimin e jetës së punonjësve në pozicionet me rrezikshmeri të lartë. Ka kontrata me palë të treta të pavarura për kontrollin e enëve në presion. Kryhen kontrole mjekësore për punonjësit të paktën 2 herë në vit.

Zbatohen rregullisht pagesat për ndihma ekonomike si dhe për zhdemtimin e tokave bujqësore.

Njësi eliminon ndikimet e mundshme negative në të drejtat e njeriut dhe siguron ndreqjen e përshtatshme nëse në ndonjë rast të drejtat e njeriut janë shkelur.

Çështjet e anti-korrupsionit dhe ryshfetit

Njësitë pritet të japin informacione materiale se si ata menaxhojnë çështjet dhe dukuritë e korrupsionit dhe ryshfetit.

Njësitë mund të marrin në konsideratë dhënien e informacioneve shpjeguese për mënyrën e organizimit, vendimmarrjes dhe menaxhimit si dhe burimet e alokuara për të luftuar korrupsionin dhe ryshfetin.

Njësitë, gjithashtu, mund të konsiderojnë shpjegimin se si ata vlerësojnë luftimin e korrupsionit dhe ryshfetit, si ndërmarrin veprime për të parandaluar ose zbutur ndikimet e pafavorshme, si monitorojnë efektivitet

in dhe si komunikojnë mbi këtë çështje brenda dhe jashtë njësisë.

TREGUESIT KRYESORË

NXJERRJA E NAFTËS

Nxjerrja e naftës nga veprimtaria prodhuese e shoqërisë Albpetrol Sh. A në fushat e naftës që ajo administron, për vitin 2022, u realizua 70 570.5 Ton kundrejt 75,920 ton te programuar, me nje baze mesatare ditore prej 193.34 Ton/dite.

Realizimi i prodhimit të naftës, si aktiviteti kryesor i shoqërisë, edhe gjatë vitit 2022, ka qenë prioritet dhe i është dhënë përparësi nga stafi drejtues dhe punonjësit e kompanisë.

Optimizimi i regjimeve të shfrytëzimit në çdo vendburim, riaktivizimi i puseve të fondit të ndalur, kryerja e punimeve dhe shërbimeve në puse në funksion të rritjes së debiteve të tyre, kanë qenë dhe po vazhdojnë të mbeten drejtimet kryesore të punës, në lidhje me këtë tregues të rëndësishëm dhe prioritar.

Kompania Albpetrol Sh. A së bashku me Qendrat e Prodhimit, të gjithë aktivitetin e saj tekniko-ekonomik për vitin 2022 e ka zhvilluar në përputhje me programin e zhvillimit si dhe detyrave të vëna në ecuri nga Bordi Drejtues i Kompanisë dhe instancat e tjera eprore.

1. Gjatë vitit 2022 janë realizuar këta tregues të prodhimit të naftës ndarë sipas Qendrave të Prodhimit dhe vendburimeve ku ato operojnë:

| Nr. | Emërtimi | QPN Fier Sektori Patos | QPN Fier Sektori Cakran-Mollaj | QPN Gorisht Sektori Gorisht-Kocul | QPN Gorisht Sektori Amonicë | QPN Gorisht Sektori Karbunarë | QPN Kuçovë | Albpetroli |
|-----|-------------------|------------------------|--------------------------------|-----------------------------------|-----------------------------|-------------------------------|------------|------------|
| 1 | Nx.nafte (ton) | 4 722.5 | 12 173 | 33 128 | 3 052.5 | 89 | 17405.5 | 70 570.5 |
| 2 | Baza ditore | 12.94 | 33.35 | 90.76 | 8.36 | 0.24 | 47.69 | 193.34 |
| 3 | Ditë pune | 4 336 | 4 463 | 18 104 | 2 743 | 93 | 280 259 | 309 998 |
| 4 | Nr.puse në punë | 20 | 19 | 96 | 19 | 1 | 969 | 1 123 |
| 5 | Nr.mes.ditë puse | 11.9 | 12.2 | 49.6 | 7.5 | 0.3 | 767.8 | 849.3 |
| 6 | Debiti mes.ditor | 1.09 | 2.73 | 1.83 | 1.11 | 0.96 | 0.06 | 0.23 |
| 7 | Koef.shfrytëzimit | 0.74 | 0.64 | 0.55 | 0.76 | 0.26 | 0.71 | 0.76 |

TREGUESIT FINANCIARË

Realizimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2022, paraqitet ne tabelën e mëposhtme

000 leke

| | |
|--|------------------|
| TE ARDHURAT | |
| 1-Te ardhuratnga aktiviteti i shfrytezimit (a+b+c+d) | 6,955,072 |
| a-Nga shitja e naftes | 4,975,673 |
| b- Nga shitja e gazit | 4,659 |
| c-Nga shitja e energjise | 1,970,602 |
| d-Sherbime te tjera | 4,138 |
| 2-Investime | 33,134 |
| 3-Te tjera te veprimtarise se shfrytezimit | 76,966 |
| 4-Te ardhura nga interesi | 6,155 |
| I- TOTALI TE ARDHURA(1+2+3+4) | 7,071,327 |
| II- Ndryshimi ne inventarin e produktit dhe prodhimit ne proces | 1,415,027 |
| SHPENZIMET | |
| 1-Materiale te para | 2,385,481 |
| 2-Personeli | 1,532,255 |
| 3-Amortizimi | 402,196 |
| 4-Shpenzime te tjera te veprimtarise se shfrytezimit | 3,676,690 |

| | |
|-------------------------------------|-----------|
| 5-Shpenzime per interesa | 3,661 |
| III- TOTALI SHPENZIME (1+2+3+4+5) | 8,000,283 |
| IV- Fitimi para tatimit (I+II-III) | 486,071 |
| V- Tatim fitimi | 469,880 |
| FITIMI NETO (IV-V) | 16,191 |